

TÜV NORD CERT

Standarti ISO 22301

Certifikimi i Menaxhimit të Vazhdimësisë së Biznesit (BCM)



Nga një zjarr i ndezur në trazira politike e duke vazhduar me pandemite, janë ngjarje që mund të ndikojnë jo vetëm procesin e blerjeve por edhe të demtojnë seriozisht proceset e biznesit të një ndërmarrje.

Në përgjithësi, kompania ka jo vetëm dëme finansiare të larta por edhe humbjet e padukshme të reputacionit etj, që rezultojnë shume të mëdha.

Minimizimi i këtyre dëmeve është qëllimi i aplikimit të standartit ISO 22301 (BCM- Business Continuity Management) i cili ju lejon të merrni masa kundër dëmeve efektive dhe rrjedhimeve të rënda.

Rreziqet në rritje në Tregun Global kanë bërë që proceset moderne të biznesit janë gjithnjë e më të espazuara ndaj copetimit. Kjo sepse proceset bazohen gjithnjë e më shumë në IT, por edhe sepse globalizimi është në rritje bashkë me outsourcing, outtasking dhe përfshirja e partnerëve të shumtë nga gjithë Bota



Avantazhet e certifikimit

Certifikimi nga një kompani e mirënjohur si TÜV NORD CERT është një nga anet pozitive. Kompanitë njëzëri anë marrin konfirmimin e egzistencës së një sistemi për proceset kritike të biznesit i cili mundëson që operacionet të vazhdojnë edhe në rrethana të jashtëzakonshme, në anën tjetër, një sistem i inspektuar dhe çertifikata e Sistemit BCM, jo vetëm ofron siguri për vetë ndërmarrjet, por ka efekte pozitive edhe mbi klientët dhe palët e interesuara:

Kjo tregon se një kompani është në gjendje të vazhdojë, edhe nëse ndodhin shqetësime serioze.

në fusha kritike të biznesit.

Njohuritë tona - për suksesin tuaj

TÜV NORD CERT është një kompani e mirënjohur certifikimi në skenën ndërkombëtare me një traditë të gjatë të shërbimit ndaj klientëve tanë.

Certifikatat tona respektohen dhe njihen në të gjithë botën. Inspektorët e NORD CERT janë specialistë dhe ekspertë shumë të kualifikuar

fushat e tyre përkatëse. Ata kanë njohuri të gjera të bazuara në përvojë, janë të pavarur dhe përgjithësisht janë të punësuar nga TÜV NORD.

Kjo do të thotë se në auditim sigurohet pavarësia, neutraliteti dhe vazhdimësia në

marrëdhëniet tona me klientët tanë. Auditorët tanë punojnë me ju dhe mbështesin zhvillimin e kompanisë suaj, duke ju dhënë reagime objektive mbi gjendjen e sistemit tuaj të menaxhimit.

Ndërprerjet e mundshme mund të jenë:

- Katastrofa natyrore si përmytjet apo tërmetet
- Ndërprerjet e energjisë dhe zjarret
- Ndërprerje dhe dëmtime të infrastrukturës
- Trazirat sociale dhe politike dhe ndryshimet drastike në skenën politike
- Aspektet shëndetësore lokale dhe globale si epidemitë dhe pandemitë
- Vjedhje apo akte terrorizmi
- Humbjet personale dhe materiale përmes sulmeve ose trazirave
- etj

Pergatitja

Sistemi i Menaxhimit të Vazhdimësisë së Biznesit përcakton planet se si mund të rifillojnë veprimet normale në kohën më të shkurtër të mundshme pas ndërprerjes. Kjo minimizon dëmtimin e kompanisë në tërësi dhe ndihmon për të shmangur kërcënimet e mbijetesës për kompaninë

Për të kontrolluar nëse sistemi i vazhdimësisë së biznesit BCM do të funksiononte, TÜV NORD CERT ofron kontrolle të vazhdueshme me certifikate.

Nga ky Auditim kompanitë marrin një opinion të pavarur dhe profesional i një eksperti neutral në lidhje me efikasitetin dhe besueshmërinë e planeve të tyre emergjente. Kërkesat përcaktohen nga ISO 22301.

Ecuria e Certifikimit

Parakushtet për certifikim përfshijnë, ndër të tjera zbatimin e politikës së sigurisë dhe një

proces i menaxhimit të rrezikut (vlerësimi dhe trajtim i rrezikut)

Certifikimi pastaj ndjek nëpër fazat e mëposhtme:

- Procesi fillestar i informacionit
- Përgatitja e auditimit
- Rishikimi i dokumentit
- Auditimi
- Lëshimi i certifikatës

Vlefshmeria

Certifikata është e vlefshme për tre vjet; secili vit ka një auditim mbikëqyrës

Auditimet janë gjithashtu të mundshme nëse është e nevojshme për të përfshirë kushte, ndryshime ose rregullime të ndryshme brenda sistemit.

Shërbimi ynë i drejtohet klientëve nga të gjithë sektorët e industrisë dhe Shërbimeve Publike.

Elvis Pazaj

Lead Auditor:

ISO 9001; ISO 14001; ISO 45001

R.A. Soc Resp ISCC EU/GHG Auditor

TÜV NORD CERT GmbH

Systemzertifizierung / System Certification

Am TÜV NORD Bulgaria -TUV NORD GROUP

1005 Tirana,

Albania

M +355 (0)692031015

F +355 (0)445 31015

E epazaj@tuev-nord.de

